



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:052299

Datë: 19.02.2019

Numri i dokumentit: 00228560

P.nr.180/18

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit E. Y. D. nga Tirana, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP, e duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP.II.nr.383-11/18 të dt.26.03.2018, në seancën gjyqësore të mbajtur me dt.**15.02.2019**, në prezencë të PSH Atnor Skoro, të dëmtuarës, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. J. I., muarrë dhe publikisht shpalli ketë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari E. D., nga i ati Y., i lindur me dt. 15.02.1987, jeton në Tiranë Rr.”B.” Laxha Q. V., ka të mbaruar arsimin e mesëm, punëtor, i martuar baba i një fëmijë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 16.01.2018 rreth orës 07,20 minuta në autostradën “I. R.” në drejtim të rrugës Prizren – Prishtinë, saktësisht “U. 11” km.40, i pandehuri duke drejtuar automjetin e tipit ”M. B.”, ngjyrë hiri, me targa AA-...-NU, i vetëdijshëm me një veprim të këtillë se mund të vij deri te pasoja e ndaluar, lehtas merre se gjer te ajo nuk do të vjen apo nëse vjen të njëjtën lehtas mund ta evitojë e gjer te e cila ka ardhur si rezultat i veprimit të tij, ashtu në atë menyrë i pandehuri duke lëvizur me veturën e tij, duke mos përshtatur shpejtësinë me kushtet dhe rrethanat e rrugës me mjegull dhe me ngrica, ku dukshmëria ishte e shkurtër dhe mos mbajtja e distancës së mjaftueshme mes mjeteve, vepron në kundërshtim me nenin 120 të Ligjit mbi rregullat e trafikut, rrezikon pjesmarësit në komunikacion dhe jetën e njerzve, i njëjti humb kontrollin e lëvizjes së automjetit, ku gjatë ndërrimit të shiritit të majtë në shiritin e djathtë, automjeti fillon të bartet në rrugë dhe me pjesën përparme të anës së majtë përplasat në mbrojtëset e urës në anën e djathtë, ku automjeti rrotullohet dhe me pjesën e prapme të anës së majtë përplasat në mbrojtësit e rrugës dhe arrin të ndalet pas 40 m, nga pika e parë e goditjes në shiritin për

ndalje emergjente, ku si pasojë e aksidentit të dëmtuarit E. D.– pëson ndrydhje të indeve të buta të krahrorit dhe dorës së majtë dhe M. D. – pëson ndrydhje të indeve të buta të krahrorit, barkut dhe gjurit të djathtë, ashtu që i pandehuri dhe e dëmtuara pësojnë lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fort (i topitur) lëndime këto të përshkruara nga eksperti mjeko ligjor Dr. B. C. të datës 15.02.2018.

Këso dore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP.

Gjykata duke aplikuar nenet 85,86, e në lidhje me nenin 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP dhe neneve 498 dhe 499 të KPP, të akuzuarit, i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Obligohet i akuzuari **E. D.** me shpenzimet e procedurës në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 €, ekspertize mjeko ligjore shumë prej 50 €, ekspertize të komunikacionit shumë prej 81.66 € dhe taksën për kompenzim të viktimave të krimit shumë prej 30 €.

E dëmtuara M. D. udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH në Prizren me aktakuzën PP.II.nr.383-11/18 të dt. 26.03.2018, ka akuzuar E. Y. D. nga Tirana, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP, të cilën aktakuzë gjatë séancës gjyqësore e ka përfaqësuar PSH Atnor Skoro, i cili në tërsi ngel pranë aktakuzës, me propozim që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. J. I. në seancë në fjalën e fundit ka deklaruar se nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale pasi që në veprimet e tija nuk formohen elementet perkatesisht figura e veprës penale për të cilën është ngarkuar pasi që eksperti i komunikacionit në mënyrë decitive ka theksuar se faktori rrugë ka qenë kyq që ka ardhur tek ky aksident dhe se i akuzuari vetëm i ka kontribuar me mos përshtatje të shpejtësisë kushteve dhe rrethanave në rrugë, e poashtu dëmi që ka pësuar i akuzuari në krahasim me kontributin e tij në aksident ku ka pasur të lënduar bashkëshorten e tij benë që dënimi i kësaj gjykate të jetë i pa arsyshëm për qështjen dhe përfundimisht ka deklaruar se në këtë rast kemi të bëjmë me vepër penale nga neni 381 të KP-së mbikqyrje e pa ndërgjegjshme e trafikut publik, pasi që kompania për mirëmbajtje të rrugëve apo Ministria e Infrastrukturës kanë dështuar ta mirëmbajnë rrugën në mënyrë që ajo të jetë e sigurve për qarkullim, me kërkesë që i akuzuari të lirohet nga akuza, pasi që nuk janë plotësuar elementet e përgjithshme dhe tiparet e posaqme të veprës penale për të cilën ngarkohet.

I akuzuari në seancë gjyqësore nuk e ka pranuar fajsin gjykata ka administruar provat dhe atë: ka dëgjuar të dëmtuarën M. D., ekspertin e komunikacionit S. Sh., ka bërë shiqimin në raportin mjekësor të spitalit rajonal në Prizren me nr. 6.. të dt. 16.01.2018, ekspertizën mjeko ligjore të dt. 15.02.2018, ekspertizën e komunikacionit të dt. 20.02.2018, skicën e vendit të ngjarjes dhe fotodokumentacioni dhe shkresat tjera që i janë bashkangjitur lëndës.

E dëmtuara M. D. e dëgjuar në cilësi të dëshmitares në seancë ka deklaruar se ditën kritike kemi qenë duke lëvizur nga pika kufitare V. në drejtim të Prishtinës. Në të hyre në autostradë kemi hasur me një mjegull të dendur, dukshmëria ishte shumë e shkurt, për qka vozitësi ka reduktuar shpejtësin e lëvizjes. Diku rreth orës 7,00 të mëngjesit tek ura e 11 ka rrëshqitur makina, është rrokullisur tri herë në autostradë dhe është ndalur në vijën fundore te emergjencës, nuk kemi qenë të goditur nga askush, por vetura e jonë është rrokullisur në autostradë. Kam vrejtur se shtresa e asfaltit ka qenë e mbuluar nga akulli i zi, nuk kam vrejtur ndonjë shenjë alarmuese për këtë rrezik në rrugë, megjithëse ka shtuar se në atë urë kan hasur edhe dy aksidente të tjera.

Si e dëmtuar ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale, kërkesën pasurore për dëmin do të kërkoj në procedurë civile.

Eksperti S. Sh. në seancë ka deklaruar se ngeli në tersi si ne mendimin e dhene me shkrim ndëras ne pytjen e mbrojtjes se me çfar shpejtësie duhet të levizte automjeti që ti shmangej aksidentit është përgjigjur se nga ekspertiza që kam berë kam konstatuar se shpejtësia e lëvizjes ka qenë rrethe 70 km ne orë, dukshmëria në rrugë ishte e zvogëluar për shkak te mjegullës së dendur dhe sipërfaqja e rrugës ishte e ngrirë, ne këto kushte rekomandohet qe shpejtësia e levizjese me qenë me e vogël se 50 km ne orë, por edhe për kundër kësaj është drejtuesi ai që duhet të ia përshtat shpejtësin e lëvizjes kushteve në rrugë ne menyrë që të mbaj automjetin nën kontroll. Në pytjen se a ka mundur i akuzuari ta shf shenjën paralajmëruese për hyrjen në urë ne kushtet e mjegullës së dendur eksperti ka sqaruar se në kushtet e mjegullës së dendur dukshmëria zvogëlohet por jo në masën qe te mos shifen shenjat e trafikut dhe drejtuesi i automjetit ka mund të shof atë, e nëse vërtetë nuk ka mund ta shof atëherë qartazi rezulton se shpejtësia e lëvizjes ka qenë e pa përshtatshme ndaj dukshmëris në rrugë. Ne pytjen se a ka qene e domosdoshme që në urë kompania e mirëmbajtjes së rrugëve apo Ministria të parandaloj krijimin e akullit të zi është përgjigjur se kompanit për mirëmbajtjen e rrugëve në bashkëpunim me Ministrin e Infrastrukturës e ne koordinim me Institutin Metrologjik të Kosovës varësisht prej temperaturave dhe kushteve klimatike kan për obligim ti mirëmbajnë rrugët në menyrë qe ato te janë të sigurta për qarkullim. Ne pytjen se cili është faktori kyq për aksidentin është përgjigjur se krijimi i akullit te zi në rrugë është shumë e vështirë të konstatohet dhe vërehet nga vozitësi, marr për bazë elementet teknike të rrugës e cila është autostradë me dy shirita me gjërsi traseje të rrafshet dhe shpejtesin e lejuar te lëvizjes faktor me më ndikim ka qenë faktori rrugë që nuk ka ofruar siguri te mjaftushme për lëvizje te sigurt te automjetit, duke mos prijashuar kontributin e drejtuesit të automjetit i cili nuk ia përshtat lëvizjen kushteve dhe rrethanave në rrugë.

I akuzuari në mbrojtjen e tij ka deklaruar se konsideroi se faktori rrugë ka qene shkaktar i aksidentit pasi që ka qene pamja e zvogëluar për shkak te mjegullës së dendur. Kam vozitur rreth 40 km ne orë për shkak te mjegullës se dendur kam qene i detyruar te lëvizi ne shpejtësi te zvogëluar, mjegulla ka bere qe pamja me qene e reduktuar deri në 5 m dhe nuk është parë me largë, për kundër faktit se kam pas te instaluara dhe të ndezura dritat e mjegullës. Ka shtuar se është rrokullisur me automjet tri here në rrugë, duke përsirur edhe nje herë se shkaktar i aksidentit ka qenë mjegulla e dendur dhe rruga me akull të zi.

Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor gjykata me pa mëdyshje ka vërtetuara këtë gjendjen faktike :

Me datë 16.01.2018 rreth orës 07,20 minuta në autostradën “I. R.” në drejtim të rrugës Prizren – Prishtinë, saktësisht “U. 11” km.40, i pandehuri duke drejtuar automjetin e tipit “M. B.”, ngjyrë hiri, me targa AA-...-NU, i vetëdijshëm me një veprim të këtillë se mund të vij deri

te pasoja e ndaluar, lehtas merre se gjer te ajo nuk do të vjen apo nëse vjen të njëjtën lehtas mund ta evitojë e gjer te e cila ka ardhur si rezultat i veprimit të tij, ashtu në atë menyre i pandehuri duke lëvizur me veturën e tij, duke mos përshtatur shpejtësin me kushtet dhe rrethanat e rrugës me mjegull dhe me ngrica, ku dukshmëria ishte e shkurtër dhe mos mbajtja e distancës së mjaftueshme mes mjeteve, vepron në kundërshtim me nenin 120 të Ligjit mbi rregullat e trafikut, rrezikon pjesmarësit në komunikacion dhe jetën e njerzve, i njëjti humb kontrollin e lëvizjes së automjetit, ku gjatë ndërrimit të shiritit të majtë në shiritin e djathtë, automjeti fillon të bartet në rrugë dhe me pjesën përparme të anës së majtë përplasat në mbrojtëset e urës në anën e djathtë, ku automjeti rrotullohet dhe me pjesën e prapme të anës së majtë përplasat në mbojtësit e rrugës dhe arrin të ndalet pas 40 m, nga pika e pare e goditjes në shiritin për ndalje emergjente, ku si pasojë e aksidentit të dëmtuarit E. D. – pëson ndrydhje të indeve të buta të krahorrit dhe dorës së majtë dhe M. D. – pëson ndrydhje të indeve të buta të krahorrit, barkut dhe gjurit të djathtë, ashtu që i pandehuri dhe e dëmtuara pësojnë lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fort (i topitur) lëndime këto të përshkruara nga eksperti mjeko ligjor Dr. B. C. të datës 15.02.2018.

Kjo gjendje faktike është vërtetuar në tersi nga ekspertiza e ekspertit Ing. S. Sh. i cili ne mendimin e dhënë me shkrim me dt. 20.02.2018 ka ardhur tek përfundimi se shkaktar i aksidentit kanë qenë lëshimet e drejtuesit te automjetit M. e te cilin e ka vozitur i akuzuari, i cili nuk ka pas kujdesin e duhur, nuk e ka përshtatur shpejtësin e lëvizjes kushteve të rrugës me mjegull dhe ngricave në rrugë, per kundër faktit se keti aksidenti i ka kontribuar edhe faktori rrugë, sipërfaqja e rrugës me ngricë, krijimi i akullit te zi ka qenë faktor i cili ka zvogëluar stabilitetin e automjetit ne rrugë. Pran këti konstatimi eksperti ka qëndruar në tersi edhe në shqyrtim gjyqësor.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitares - të dëmtuarës M. D. nga ku ka provuar faktin se ditën kritike deri sa po udhtonin në relacionin V. – Prishtinë në kushtet e dukshmeris së zvogëluar mjegull e dendur, rruga me ngrica, tek ura e 11 automjeti te cilin e ngiste i akuzuari është rrokullisur tri herë duke shkaktuar aksident edhe pse nuk ishte ndeshur me askënd tjetër por duke goditur anësoret e rrugës, meqë rast edhe ka marr lëndime trupore .

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar edhe nga skica e vendit të ngjarjes nga ku provohet se nga pika fillestare e futjes ne urë dhe pika e pare e kontaktit të automjetit me mbrojtësin e urës, automjeti kaluar dhe ka ndaluar në distancë rrethe 40 m. që provon faktin se shpejtësia e lëvizjes nuk ka qenë në përputhje me kushtet dhe rrethanat në rrugë.

Kjo gjendje faktike vërtetohet edhe nga fotodokumentacioni në shkresat e lendes ku shifet se mjegulla nuk ka qenë i intenzitetit që me pamundësuar pamjen në përmasa që mos të shifet se automjeti po futet në urë ,dhe dëmtimet në automjet vertetojn faktin se automjetei është ndeshur me rrethojat e urës dhe ka pas vërtet rrokullisje ngase dëmet janë në pjesen e parë dhe të pasme të automjetit.

Ketë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar pjesërisht edhe nga mbrojtja e te akuzuarit i cili ne mbrojtjen e tij ka provuar faktin se ditën kritike ka vozitur në relacionin V. – Prishtinë, dhe si rezultat i pamjes së zvogëluar për shkak te mjegullës së dendur ka ardhur te aksidenti dhe automjeti është rrokullisur tri herë në rrugë.

Natyren dhe shkallen e lëndime që ka pësuar e dëmtuara gjykata e ka vërtetuar me ekspertizen e ekspertit mjeko ligjor Dr. B. C. të dates 15.02.2018 dhe raportit mjekësor i lëshuar nga Spitali rajonal në Prizren me nr.6.. i dt.16.01.2018.

Nga nje gjendje e tille faktike e vertetuar, gjykata vendos të akuzurin të shpallë fajtor dhe i shqiptoi vrejten gjyqësore me bindjen se edhe me vërejtjen e shqiptuar do të arrihet në tërsi qëllimi i denimit, duke ndikuar te kryesit në parandalimin e veprave penale në të ardhëmen si dhe në personat të tjerë, gjithashtu denimi i shqiptuar do të ndikoi pozitivisht tek i akuzuari dhe personat tjerë për respektimin e ligjit.

Gjykata me rastin e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore pati parasysh rrethanat nga neni 86 par. 5 të KP, si rrethanat në të cilat vepra është kryer, shkallen e përgjegjesis penale të kryerjes, vlerën e të mirës së mbrojtur dhe demit të shkaktuar. Si rrethan letësuese gjykata mori fakin se i njejt nuk ka qenë me parë i denuar, është familjar, sjelljen korrekte në gjykatë, faktin se e demtuara nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale, faktori rrugë i ka kontribuar me të madhe kësaj vepr penale, e dëmtuar është bashkëshortja e të akuzuarit.

Vendimi mbi kërkesen pasuroro juridike u muarrë në kuptim të nenit 463 të KPP

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 par. 1 të KPP.

Vendimi me të cilin është obiliguar i akuzuari që të bëjë kompenzimin e viktimës së krimit është marrë konform nenit 39 paragrafi 3 nënparagraf 3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA NË SUHAREKË,
P.nr.180/18 të dt. 15.02.2019**

**Sek. Juridike
F. Kabashi**

**G j y q t a r i
Robert Tunaj**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.